



Datë: 03.11.2025
Numër Protokolli: 2275/2025

A.nr.224/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë dhe Avdyl Bektashi-në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1199/2022 të datës 10.01.2024 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimit AA.nr.238/2022 të datës 11.09.2025 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, ka rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.224/2022 të datës 11.03.2022 të parashtruar nga ankuesi Z.B nga Ferizaj, kundër organit të punësimit-Komuna e Ferizajit, në çështjen juridike “*Kompensim material*” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 03.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.224/2022 e datës 11.03.2022 e parashtruar nga ankuesi Z.B.

II. Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Ferizajit, që të ndërmarr të gjitha veprimet që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë zbatimin e këtij vendimi, në mënyrë që ankuesi të kompensohet në emër të diferencës së koeficientit nga data e lëshimit të Akt Emërimit më datë 01.05.2020 deri me datë 22.12.2021 kur ankuesi ka parashtruar kërkesën te organi i punësimit.

III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës, që në pajtim me vendimin e pranuar nga Komuna e Ferizajit, konformë Pikës II të dispozitivit të këtij vendimi të bëjë ekzekutimin e vendimit të Komunës së Ferizajit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi Z.B i punësuar në Komunën e Ferizajit, sipas kontratës me numër 296/2010 të datës, përmes së cilës kontratë i njëjti ka filluar punën më datë 01.11.2010, në pozitën Zyrtar administrativ dhe

financiar në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me datë 01.05.2020, Kryetari i Komunës së Ferizajt ka nënshkruar plotësim ndryshimin e akt emërimit për ankuesin në pozitën Udhëheqës i Sektorit të Kadastrit në Drejtorinë për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër me koeficient të pagës nëntë (9). Ankuesi me datën 22.12.2021 ka parashtruar kërkesë te Kryetari i Komunës së Ferizajt, për zbatimin e ndryshimit dhe plotësimit të akt emërimit të datës 01.05.2020 si dhe kompensimin e diferencës sipas koeficientit 9. Menaxherja e Personelit në Komunën e Ferizajt, në përgjigje të kërkesës së ankuesit me datë 25.02.2022 ka njoftuar të njëjtin se kërkesën për zbatim të koeficientit të pagës sipas Akt Emërimit të datës 01.05.2020, me datat 08.02.2021, 08.04.2021, 07.05.2021, 09.08.2021 dhe 10.01.2022 e ka përcjellë tek Ministria e Administratës Publike, mirëpo këto kërkesa nuk janë realizuar për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore.

Ankuesi i pakënaqur me përgjigjen e Zyrës së Personelit të Komunës së Ferizajt, brenda afatit ligjor respektivisht me datën 11.03.2022, ka ushtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me harmonizimin e koeficientit sipas akt emërimit të datës 01.05.2020 si dhe kompensimin në mënyrë retroaktive të pagave nga data e marrjes se plotësim ndryshimit të akt emërimit të datës 01.05.2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, me datë 15.03.2022 ka dorëzuar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit te Komuna e Ferizajt, ndërsa Këshilli me datën 31.03.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Ferizajt së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.04.2022 ka nxjerr Vendim me numër A.nr. 224/2022, me të cilin vendim e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e ankuesit. Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër A.nr.224/2022 të datës 20.04.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka iniciuar konflikt administrativ në gjykatën kompetente përkatësisht në Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 10.01.2024 nxjerr Aktgjykim me numër A.nr.1199/2022 me të cilin e aprovon si të bazuar kërkesë padinë e paditësit, duke anuluar vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër këtij aktgjykimi, më datë 16.02.2024 parashtron ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë. Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative me datë 11.09.2025 nxjerr Aktgjykim me numër AA.nr.238/2024 me të cilin e refuzon si të pa bazuar ankesën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa e vërteton Aktgjykimin me numër A.nr.1199/2022 të datës 10.01.2024 të gjykatës së shkallës së parë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1296/2022 të datës 11.03.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje e datës 25.02.2022 nga Komuna e Ferizajt; Formularin e datës 10.01.2022; Formularin e datës 08.02.2021; Formularin e datës 08.04.2021; Formularin e datës 07.05.2021; Formularin e datës 09.08.2021; Formularin për kërkesë apo ankese të datës 22.12.2021; Kërkesën e ankuesit të datës 22.12.2021 e parashtruar për Komunën e Ferizajt; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të datës 01.05.2020; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të ankuesit të datës 18.06.2013; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të ankuesit të datës 05.09.2012; Akt emërimit të ankuesit të datës 01.07.2022; Kontratën e marrëdhënies së punës së ankuesit të datës

31.10.2011; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.03.2022; Përgjigjen në ankesë të datës 31.03.2022 nga Komuna e Ferizajt me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimit të ankuesit të datës 01.07.2011; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të ankuesit të datës 05.09.2012; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Përgjigjen në kërkesën e ankuesit të datës 25.02.2022 nga Komuna e Ferizajt; Formularin PDP për përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit të datës 28.06.2012; Formularin PDP për përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit të datës 03.01.2015; Formular i të dhënave për listën e pagave e datës 10.05.2022; Formular i të dhënave për listën e pagave për muajin gusht 2021; Formular i të dhënave për listën e pagave për muajin prill 2021; Aktgjykimin A.nr.1199/2022 të datës 10.01.2024 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Ankesën e datës 24.10.2022 e parashtruar në Gjykatën e Apelit të Kosovës dhe Aktgjykimin AA.nr.2238/2024 të datës 11.09.2025 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji i Këshillit , pasi ka rishqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët si dhe duke marr parasysh pikëpamjet juridike sipas Aktgjykimit A.nr.1199/2022 të datës 10.01.2024 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimit AA.nr.238/2024 të datës 11.09.2025 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesi është e **bazuar, sepse:**

Kolegji i Këshillit,duke marr parasysh të gjeturat si në Aktgjykimin A.nr.1199/2022 të datës 10.01.2024 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimin AA.nr.238/2022 të datës 11.09.2025 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, konstatoj se pretendimet e tij, që të bëhet kompensimi i pagës sipas plotësimit dhe ndryshimit të akt emërimit të datës 01.05.2020, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave ligjore të aplikueshme në kohë lidhur me pagat e nëpunësve civil, konkretisht dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyratë Publike, përkatësisht nenit 19 ku përcaktohet se: *"Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave"*, nenit 5 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil ku përcaktohet se *"1. Paga bazë, sipas këtij ligji është rezultat i çmimit të punës, përkatësisht vlerës për punën e thjeshtë dhe koeficientet e caktuar për çdo grup e nëngrup, si dhe shumat e rritura të përvojës së punës, për çdo vit të plotë, në përqindje të caktuar"*, nenit 9 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ku është përcaktuar se: *"Nëpunësit civil kanë të drejtë të marrin pagën për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës"*, e për rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave si dhe duke marrë parasysh konstatimin se ankuesi ushtron pozitën e Udhëheqësit të Sektorit të Kadastrit sipas plotësim ndryshimit të Akt emërimit të datës 01.05.2020 me koeficient nëntë (9) të pagës, Kolegji i Këshillit bazuar edhe në pikëpamjet juridike të aktgjykimeve në lidhje me këtë çështje dhe që u specifikuan më lartë vlerëson se është i bazuar pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me realizimin e koeficientit të pagës sipas Akt emërimit të datës 01.05.2020, sikurse është i bazuar pretendimi për kompensim retroaktiv sipas këtij plotësim ndryshimi të aktit të emërimit.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, konstaton se organi përkatës i punësimit në këtë rast Komuna e Ferizajt, ka ndërmarr të gjitha veprimet që të realizohet koeficienti i ankuesit sipas plotësim ndryshimit të akt emërimit duke dërguar formularët për pages më datë 08.02.2021, 08.04.2021, 07.05.2021, 09.08.2021 dhe 10.01.2022, mirëpo që nuk janë realizuar, kështu që bazuar në dispozitat e aplikueshme në kohë, Kolegji vlerëson se pretendimet e ankuesit për kompensim të pagës sipas koeficienti nëntë (9), janë të bazuara, andaj Komuna e Ferizajt, respektivisht Njësia e Burimeve Njerëzore është e obliguar që të ndërmarr të gjitha veprimet që të dërgoj në Thesarin e Republikës Kosovës, kërkesën për kompensimin e diferencës së pagës për ankuesin për periudhën nga data 01.05.2020 deri më datë 22.12.2021, në mënyrë që Thesari i Republikës së Kosovës të bëjë ekzekutimin sipas kërkesës së organit të punësimit.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.224/2022, datë 03/11/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit Z.B;
- Znj.Luljeta Maxhuni, Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Ferizajit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.